



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Veriore
Opština Severna Mitrovica – Municipality of Mitrovica North

Kryetari i Komunës

Nr. _____ . Data: __/11/2024.

Mitrovicë Veriore

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 82 i Statutit të Komunës Nr. 10-030/01-0007269/24 të datës 28.06.2024, Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr. 10-030/01-0001251/24 i datës 31.01.2024 si dhe Raport-Rekomandimit Nr. 08-030/01-0012262/24 i datës 31.10.2024 të Komisionit për shqyrtimin e Kërkesave për ndarjen e mjeteve financiare për fëmijët e lindur në vitin 2024, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

1. **Miratohet** Raport – Rekomandimi i Komisionit për shqyrtimin e Kërkesave për ndarjen e mjeteve financiare për fëmijët e lindur në vitin 2024, Nr. 08-030/01-0012262/24 i datës 31.10.2024 dhe lejohet shfrytëzimi i mjeteve financiare nga buxheti i Komunës së Mitrovicës Veriore në shumë totale prej **3600 €**.
2. Mjetet financiare sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi lejohen me qëllim të subvencionimit për fëmijët e lindur në vitin 2024 e të cilët janë banorë rezident të Komunës së Mitrovicës Veriore. Pas shqyrtimit të kërkesave adresuar Komisionit dhe Raport-Rekomandimit nga Komisioni, përfitues të përkrahjes financiare në shumë prej **300 €** janë gjithsej **12** aplikues, respektivisht kërkesa të miratuara.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Rekomandimi Nr. 08-030/01-0012262/24 i datës 31.10.2024 i nxjerrë nga Komisioni në bazë të të cilit do të bëhet ekzekutimi i mjeteve financiare.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet, Financa dhe Zhvillim Ekonomik, ndërsa mjetet e parapara sipas këtij vendimi, për 10 (dhjetë) fëmijë paguhën nga blloku kodues 16938 nga Kuvendi Komunal, ndërsa për 2 (dy) fëmijë paguhën nga blloku kodues 16674 nga Inspektimet në kategorinë ekonomike Subvencione dhe Transfere.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni për shqyrtimin e Kërkesave për ndarjen e mjeteve financiare për fëmijët e lindur në vitin 2024, i formuar me Vendimin e Kryetarit të Komunës Nr. 01-030/01-0002411/24 i datës 27.02.2024, pas shqyrtimit të kërkesave adresuar Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, ka nxjerrur Rekomandimin Nr. 08-030/01-0012262/24 i datës 31.10.2024. Komisioni ka shqyrtuar gjithsej 12 kërkesa, që të gjitha prej tyre i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret dhe janë rekomanduar për përkrahje.

Kryetari i Komunës pasi shqyrtoi Raport – Rekomandimin e Komisionit për shqyrtimin e Kërkesave për ndarjen e mjeteve financiare për fëmijët e lindur në vitin 2024 dhe e trajtoi atë të arsyeshëm, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Komunës së Mitrovicës Veriore

Shtojcë:

Raport - Rekomandimi i Komisionit për shqyrtimin e Kërkesave për ndarjen e mjeteve financiare për fëmijët e lindur në vitin 2024, Nr. 08-030/01-0012262/24 i datës 31.10.2024

T'i dorëzohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
- 1x1 Drejtorisë për Buxhet, Financa dhe Zhvillim Ekonomik
- 1x1 Arkivit